



PARTITË OPOZITARE E KANË KRITIKUAR KRYEMINISTRIN RAMUSH HARADINAJ PËR ÇËSHTJEN E DEMARKACIONIT ME MALIN E ZI **FAQE 4-5**

Një vit nga ratifikimi i demarkacionit, asnjë veprim për korrigjimin e tij

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, është kritikuar nga liderët e dy subjekteve më të mëdha opozitare, LDK-ja dhe LV-ja, për mosndërmarrjen e asnjë veprimi për korrigjimin e marrëveshjes së demarkacionit Kosovë - Mal i Zi edhe një vit pas ratifikimit të saj në Kuvend. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, dhe ai i LV-së, Albin Kurti, kanë thënë se kjo tregon se kryeministri Haradinaj kundërshtimin ndaj kësaj marrëveshje e ka pasur vetëm për t'u bërë kryeministër. Ndërsa kryediplomati malazez Srdjan Darmanoviq nuk e konsideron këtë çështje si të hapur ndërmjet dy vendeve



LIMAJ: KOSOVA ËSHTË E PACENUESHME, NË BRUKSEL SHKOJMË PËR NJOHJE

Republika e Kosovës është e pandashme dhe në dialogun e Brukselit shkojmë për njohje nga Serbia. Kështu ka deklaruar bashkëkryesuesi i ekipit negociator të Kosovës, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj, në debatin publik të organizuar nga Qendra Mediale në Çagllavicë. Ai ka thënë se në



dialog Kosova do t'i ngrehë temat të cilat janë në interes të saj, por epilogu i këtij procesi duhet të jetë njohja reciproke

KOSOVË 2 - 2 DANIMARKË

Kosova nuk koritet ndaj Danimarkës **FAQE 11**



AKTUALE

KORRIGJIMI I 'LEHTË' I KUFIJVE DHE DEGRADIMI I RËNDË I KOSOVËS **F. 11**



Behxhet Sh. SHALA - THAÇI



DARMANOVIQI: KORRIGJIMI I TERRITOREVE NUK ËSHTË IDEJA MË E MIRË **F. 2**

SOT I JEPET LAMTUMIRA E FUNDIT NËNËS SË HEROIT EDMOND HOXHA **F. 10**

EKONOMI

KOSOVA DHE MALI I ZI NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE NË FUSHËN E KONTROLLIT TË MALLRAVE STRATEGJIKE **F. 9**

IMPLEMENTIMI I TATIMIT NË TOKA, NJË NGA REFORMAT MË TË RËNDËSISHME PËR KOMUNAT **F. 8**

SPORT

SHQIPËRIA ME FITORE SYNON T'I NISË ELIMINATORET PËR EVROPIAN **F. 14**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, Viasat, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Ministri i Jashtëm malazias, Srdjan Darmanoviq, është takuar me udhëheqësit e institucioneve të Kosovës

Darmanoviqi: Korrigjimi i territoreve nuk është ideja më e mirë

Ministri i Jashtëm malazias, Srdjan Darmanoviq, ka thënë të enjten në Prishtinë, se shteti i tij ka një shqetësim sa i përket idesë së korrigjimit të territorit në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Kjo nuk është ideja më e mirë", ka thënë Darmanoviq. Megjithatë, ai ka thënë se nëse një gjë e tillë është e mirë për fqinjët, Kosovën dhe Serbinë, atëherë do të jetë e mirë edhe për Malin e Zi



të mirë, që në Ballkan të mbyllen çështjet e hapura. Shpresojmë se Serbia dhe Kosova të gjejnë zgjidhje për marrëdhëniet e tyre", ka thënë Darmanoviq në një konferencë të përbashkët për medie me homologun e vet nga Kosova, Behgjet Pacolli.

Ministri Darmanoviq, po ashtu, ka thënë se zgjidhja e çështjes Kosovë - Serbi do të nënkuptonte që të

dyja vendet ta njohin njëra-tjetrën. Ndërkaq zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka thënë se Republika e Kosovës dhe Mali i Zi kanë arritur të ndërtojnë marrëdhënie të shkëlqyera si dy shtete fqinje. "Do të vazhdojmë që të avancojmë edhe më tutje këtë bashkëpunim ndërshtetëror në të gjitha fushat e interesit të për-

bashkët në mes dy vendeve", ka thënë Pacolli.

Bashkëpunimi në fushën e integritetit ka qenë një nga çështjet e diskutuara në kuadër të këtij takimi, për të cilën të dy ministrat kanë nënshkruar edhe një marrëveshje. "Kjo marrëveshje ofron bazë për bashkëpunim në fushën e integritetit, inkurajon edhe bashkëpunimin rajonal, ndihmon përfarimin e vlerave të përbashkëta evropiane, bashkëpunimin ekonomik, në fushën e legjislacionit etj. Ne kemi çka të mësojmë, por kemi edhe vetë çka të ofrojmë në këtë proces, në fund të të cilit synojmë, që të jemi pjesë edhe formale e familjes së madhe evropiane", ka thënë ministri i Jashtëm Pacolli.

Në vazhdim, ai ka falënderuar homologun nga Mali i Zi, Darmanoviq, për mbështetjen e vazhdueshme që ky shtet i ka dhënë vendit tonë për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, për kontributin konkret që ky shtet po e jep për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë përmes pjesëmarrjes në trupat e KFOR-it, ndërkohë që një vëmendje e posaçme i është dhënë edhe thellimit të mëturshëm të bashkëpunimit në fushën e ekonomisë. "Ekziston potencial i jashtëzakonshëm, duhet të shfrytëzohen më mirë lidhjet ekzistuese edhe në mes të qeverive, por edhe në mes të afaristëve. Ne si Qeveri po bëjmë përpjekje që ta përmirësojmë sa më tepër këtë klimë, por edhe infrastrukturën rrugore dhe të bëjmë lehtësime për bizneset në të dyja shtetet", ka thënë numri dy i qeverisë, Pacolli. Të drejtat, integrimi dhe krijimi i mundësive më të mira për komunitetet kanë qenë tema që, gjithashtu, janë diskutuar në mes dy ministrave. "Vazhdimisht jemi zotuar se do të bëjmë gjithçka mundemi, që të ofrojmë mundësi edhe më të mira për këtë komunitet, që është pasuri e Kosovës dhe urë e fuqishme lidhëse mes dy shteteve dhe popujve", është shprehur ministri Pacolli.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 MARS - Mali i Zi përkrah çdo opsion që do të çonte në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por ideja e korrigjimit të territoreve nuk është ideja më e mirë. Kështu ka thënë të enjten në Prishtinë, ministri i Jashtëm malazias, Srdjan Darmanoviq. "Ne e shohim një dialog intensiv, i cili kohë pas kohe

është ndërprerë me mospajtime politike. Shohim se ka koncepte të ndryshme rreth zgjidhjes. Një nga konceptet është për korrigjimin e territoreve. Ne nuk përzihemi në çështje të brendshme ndërmjet dy vendeve. Kemi disa brenga rreth mundësive për korrigjim të territoreve. Kjo nuk është ideja më e mirë, por nëse kjo është e mirë për fqinjët tanë dhe ata merren vesh, atëherë do të jetë e mirë edhe për ne. Kështu që e kemi qëllimin më



Darmanoviqi takohet edhe me Veselin dhe Haradinajn, flasin për forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve

Ministri i Jashtëm të Malit të Zi, Srdjan Darmanoviq, e ka pritur në takim të enjten edhe kryetari i Kuvendit Kosovës, Kadri Veseli. Veseli dhe Darmanoviqi diskutuan për marrëdhëniet që Kosova dhe Mali i Zi kanë ndërtuar midis tyre si dhe për mundësinë e avancimit të tyre në të gjitha sferat e bashkëpunimit, në të mirë të qytetarëve të të dyja vendeve.

Kryeparlamentari Veseli ka thënë se Kosova mbetet e përkushtuar për kultivimin e politikës së saj të fqinjësisë së mirë e të bashkëpunimit me të gjitha vendet e rajonit, përfshirë këtu edhe Malin e Zi, në funksion të

forcimit të stabilitetit rajonal e të integritetit më të shpejtë evropian.

Nga ana e tij, ministri i Jashtëm malazias, Darmanoviq, pasi shprehu kënaqësinë që gjendet për vizitë në Kosovë, theksoi nevojën e kultivimit të mëtejshëm të bashkëpunimit midis Prishtinës dhe Podgoricës zyrtare. Ai ka thënë se vizita e tij në Prishtinë është mesazh i këtij bashkëpunimi dhe mëton t'i japë një shtysë të fuqishme avancimit të marrëdhënieve ndërshtetërore dhe ndërparlamentare Kosovë - Mal i Zi.

Ministri i Jashtëm i Malit të Zi, Srdjan Darmanoviq, është takuar edhe me kryemi-

nistrin Ramush Haradinaj. Ky i fundit ka thënë se shtylla të rëndësishme të politikës së jashtme të Kosovës janë paqja, stabiliteti dhe ndërtimi i fqinjësisë së mirë me vendet e rajonit, vlera të përbashkëta të cilat i ndanë me Malin e Zi. "Takim miqësor me ministrin e Jashtëm të Malit të Zi, Srdjan Darmanoviq, për thellimin e marrëdhënieve bilaterale, bashkëpunimin ekonomik dhe partneritetin politik. Si dy shtete, që nuk kanë çështje të hapura, Kosova dhe Mali i Zi shërbejnë si shembull në rajon për përkrahje të ndërsjellë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian", ka thënë Haradinaj.

Vuçiçi: Vonesat në dialogun me Kosovën mund ta ndezin rajonin

BEOGRAD, 21 MARS - Vonesat për rifillimin e bisedimeve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë mbi normalizimin e marrëdhënieve mund të destabilizojnë Ballkanin. Perëndimor i cili ende po këndellet nga luftërat e viteve '90, tha në një intervistë për "Reuters"-in presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi. "Çdo ditë vonesë mund të

krijohë kushte në të cilat një shkëndijë mund ta ndezë në flakë tërë rajonin. Vendet perëndimore duhet ta dinë këtë", tha Vuçiçi. Për ta rifilluar dialogun, Serbia kërkon nga Prishtina ta heqë tarifën ndaj mallrave serbe të vendosur në nëntor të vitit të kaluar si kundërpërgjigje të asaj që Prishtina e quan fushatë të Serbisë

për parandalimin e anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare.

Ndërkohë presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiçi dhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e kanë përmendur si ide ndryshimin e kufijve si pjesë e një marrëveshjeje të paqes mes dy vendeve. Vuçiçi këtë e quan "përcaktim të kufirit",

ndërkaq Thaçi "korrigjim të kufijve". Mirëpo shumë analistë këtë ide e shohin si një përpjekje shkëmbime territoriale.

"Pranimi i Serbisë në Bashkimin Evropian varet nga dialogu me Prishtinën dhe nëse një ditë do të arrijmë një marrëveshje", ka thënë në këtë intervistë presidenti serb Vuçiçi, duke shtuar se ai pret që



Gjermania, Franca apo BE-ja të bëhen më aktive në procesin negociues. "Unë mendoj se ne do t'i shohim disa prej nismave të tyre në të ardhmen e afër", tha Vuçiçi, pa dhënë më shumë detaje.

Limaj: Kosova është e pacenueshme, në Bruksel shkojmë për njohje



Republika e Kosovës është e pandashme dhe në dialogun e Brukselit shkojmë për njohje nga Serbia. Kështu ka deklaruar bashkëkryesuesi i ekipit negociator të Kosovës, zëvendëskryeminstri Fatmir Limaj, në debatin publik të organizuar nga Qendra Mediale në Çagllavicë. Ai ka thënë se në dialog Kosova do t'i ngrehë temat të cilat janë në interes të saj, por epilogu i këtij procesi duhet të jetë njohja reciproke. Sa i përket platformës për dialog, Limaj ka thënë se ajo është derivat i Kushtetutës së Kosovës, Pakos së Ahtisarit dhe vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

qëndrimin zyrtar të Kosovës në bisedimet me Serbinë dhe se ajo është derivat i Kushtetutës së Kosovës, Pakos së Ahtisarit dhe vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. "Platforma nuk ka asgjë të re dhe nuk do të duhej ta befasonte askënd. Platforma është derivat i dokumenteve mbi bazën e të cilave funksionon shteti i Kosovës. Platforma është derivat i Kushtetutës, Deklaratës së Pavarësisë, vendimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. E kemi bërë këtë platformë për ta rikonfirmuar pozicionin zyrtar që Kosova shkon në bisedime në Bruksel për njohjen e Kosovës nga Serbia. Kosova është e gatshme të bisedojë për tema të cilat janë të rëndësishme për të dy vendet tona. Si Kosovë kemi nxjerrë disa tema të cilat na interesojnë të bisedohen dhe të jenë pjesë e marrëveshjes sikurse që presim që edhe Serbia të dalë me temat që i interesojnë", ka theksuar ai, duke shtuar se platforma ka vendosur në binarë procesin e dialogut Kosovë - Serbi.

"Kemi arritur ta fusim në binar rrugën e dialogut të mundshëm me Serbinë. Siç e dini, Kosova ka formuar një delegacion shtetëror që është votuar në Kuvendin e Kosovës dhe qëllimi dhe objektivi kryesor ka qenë që Kuvendi si institucioni më i lartë të jetë i përfshirë në këtë proces, të kemi transparencë dhe të ketë sa më

shumë gjithëpërfshirje. Qeveria e Kosovës nuk ka dashur që ta vazhdojë praktikën nga e kaluara, që këtë temë tepër të rëndësishme ta kufizojë në individë të caktuar apo vetëm në qeveri, prandaj kemi dashur që pjesëmarrës të jetë edhe Kuvendi. Kemi ftuar edhe partitë opozitare por, siç e dini, deri më tani është përgjigjur vetëm PSD-ja. Partitë e tjera opozitare janë për dialog, por kanë vërejtjet dhe kundërshtitë e tyre për ato që kanë ndodhur deri më tani dhe për çështje të tjera që ne mund t'i kuptojmë si qëndrim opozitar. Delegacioni ka pasur për detyrë të ndërtojë një platformë si pozicion zyrtar i Republikës së Kosovës në dialogun me Serbinë", ka deklaruar Limaj. Ai ka shprehur gatishmërinë e shtetit të Kosovës për ta vazhduar procesin e dialogut por, sipas Limajt, kjo çështje varet edhe nga vullneti i palës serbe. "Nuk kemi bërë asgjë përveç asaj që Serbia duhet ta njohë realitetin që jeton Kosova tash e 11 vjet si shtet i pavarur. Pse gjithë ajo zhurmë në Beograd? Ata janë takuar dhe vazhdojnë të takohen me Kosovën. Ata e dinë që Kosova ka Kushtetutë, e ka shpallur pavarësinë si dhe pavarësia e saj është legjitimuar nga GjND-ja pikërisht me kërkesë të Serbisë. Kosova ka një propozim zyrtar në dialogun me Serbinë, mirëpo ne ende nuk e kemi një qëndrim zyrtar të Serbisë se me çka është

e gatshme ta njohë Republikën e Kosovës. Ne jemi gati qysh nesër ta fillojmë dialogun, por kjo varet edhe nga vullneti i palës serbe", ka theksuar zëvendëskryeminstri Limaj.

Ndërsa kryetari i Partisë Demokratike Progresiste, Nenad Rashedi, ka thënë se asnjëherë më parë nuk ka pasur ndarje kaq të madhe dhe urrejtje në mes të serbëve në Kosovë. Ai i ka bërë thirrje presidentit Vuçiq që t'i ndalë akuzat ndaj kundërshtarëve. "Fatkeqësisht, pasoja e incidentit është ajo ndarja apo etiketimi, ndarja me serbët e mirë dhe të këqij. Ky tension që ekziston shumë shpesh dhe më së shpeshti vjen nga presidenti i Serbisë. Thjesht, rezulton me atë që kemi një situatë totale absurde në të cilën asnjëherë nuk ka pasur kaq shumë ndarje dhe urrejtje mes serbëve", ka deklaruar Rashedi, duke shtuar se serbët e Kosovës kanë mbetur të askujt.

Ndërsa Aleksander Dikiq nga Forumi Nacional i Serbëve ka thënë se përderisa në Kuvendin e Kosovës diskutohet për dialogun si dhe është formuar ekipi negociues, në Serbi nuk po ndodh e njëjta gjë, madje ende nuk dihet qëndrimi zyrtar i Beogradit. Kurse analisti politik Fadil Lepaja, duke folur për dialogun dhe platformën, ka thënë se varet nga Serbia sa është e gatshme ta pranojë raportin e ri me Kosovën.

EPOKA E RE


Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 21 MARS - Bashkëkryesuesi i ekipit negociator, zëvendëskryeminstri Fatmir Limaj, ka thënë të enjten se Kosova është e pandashme dhe territori i saj është i pacenueshëm. Në këtë kontekst ai ka thënë se Kosova shkon në dialogun e Brukselit për njohjen nga Serbia. "Dialogu i mundshëm në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të ketë emër dhe ai emër duhet të jetë dialog për njohje apo dialog për njohjen reciproke. Në dialog shkojmë për njohje, Kosova është e pandashme dhe territori i saj është i pacenueshëm. Pa njohje nuk ka kuptim asnjë bisedim. Ne nuk shkojmë në Bruksel të bisedojmë për kanalizime e për

gjëra të tjera", ka deklaruar Limaj në debatin publik të organizuar nga Qendra Mediale në Çagllavicë. Ai ka treguar se në procesin dialogues, Kosova do t'i ngrehë disa tema të cilat janë në interes të vendit tonë, por epilogu i këtij procesi duhet të jetë njohja reciproke. "Procesi i dialogut të Brukselit duhet të përfundojë me njohjen reciproke dhe mbylljen njëherë e mirë të temave të hapura në mes të Kosovës dhe Serbisë. Duhet t'ua japim mundësinë popujve dhe vendeve tona për t'i realizuar interesat strategjike drejt integriteteve evropiane nëpërmjet një marrëveshje që ofron mirëqenie dhe perspektivë për të dyja vendet", është shprehur Limaj. Kurse sa i përket platformës për dialog, zëvendëskryeminstri Limaj ka thënë se ajo paraqet

Partitë opozitare e kanë kritikuar kryeministrin Ramush Haradinaj për çështjen e demarkacionit me Malin e Zi

Një vit nga ratifikimi i demarkacioni



Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, është kritikuar nga liderët e dy subjekteve më të mëdha opozitare, LDK-ja dhe LV-ja, për mosndërmarrjen e asnjë veprimi për korrigjimin e marrëveshjes së demarkacionit Kosovë - Mal i Zi edhe një vit pas ratifikimit të saj në Kuvend. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, dhe ai i LV-së, Albin Kurti, kanë thënë se kjo tregon se kryeministri Haradinaj kundërshtimin ndaj kësaj marrëveshje e ka pasur vetëm për t'u bërë kryeministër. Ndërsa kryediplomati malazez Srdjan Darmanoviq nuk e konsideron këtë çështje si të hapur ndërmjet dy vendeve

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 21 MARS - Një vit pas ratifikimit në Kuvendin e Kosovës të marrëveshjes së demarkacionit me Malin e zi, subjektet opozitare e kanë kritikuar kryeministrin Ramush Haradinaj për mosndërmarrjen e asnjë hapi për korrigjimin e kësaj marrëveshje.

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, dhe kryetari i LV-së, Albin Kurti,

kanë deklaruar se kundërshtimi i Haradinajt për këtë marrëveshje sa ishte në opozitë ka qenë vetëm për t'u bërë kryeministër i vendit. I pari i LDK-së e ka pyetur kryeministrin dhe kundërshtarët e kësaj marrëveshje, se ku është sot kufiri në mes këtyre dy shteteve. "Për aq sa mbaj mend, nga vjeshta e vitit 2015 e deri në fund të vitit 2016, duke marrë shkas nga kjo marrëveshje, u organizuan veprime të dhunshme dhe

kriminale nga ata që ndërtuan kauzën se Kosova me këtë marrëveshje po humbet 8 200 hektarë. U pengua puna e Kuvendit duke hedhur gaz lotsjellës, shishe të ujit e sprej të syve; nga gurët dhe objektet e forta të protestuesve u plagosën shumë policë, disa edhe me pasoja afatgjata; iu vë flaka me shishe molotovi ndërtesës së Qeverisë, u sulmua me minahedhës ndërtesa e Kuvendit; u sulmuan ministrat me vezë në

Haradinaj: Personat me sindromën Down do ta kenë statusin e merituar

PRISHTINË, 21 MARS (ER) - "U takojmë popujve që janë më solidarë, më të kuptueshëm, të pranueshëm dhe vlerat njerëzore i kemi të çmuara", ka thënë kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në konferencën "Aftësia e kufizuar intelektuale në Kosovë", e cila është organizuar nga Shoqata Down Syndrome Kosova në kuadër të Ditës

Ndërkombëtare të Personave me sindromën Down. Me këtë rast, kryeministri ka falënderuar të gjitha organizatat dhe donatorët që në mënyra të ndryshme kanë mbështetur Shoqatën Down Syndrome Kosova, duke thënë se kjo është një dëshmi e një ndjenje të ndërsjellë që kemi për secilin dhe tregon kujdesin për këta persona. "Qeveria e Kosovës,

me avancimin e kornizës ligjore për përkrahjen e personave me sindromën Down, për këtë vit ka miratuar konceptdokumentin për hartimin e projektligjit për gjithëpërfshirje. Me këtë projektligj do të sigurohemi që të gjithë personat me sindromën Down të kenë përfitimet, vendin dhe statusin e merituar", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.



t, asnjë veprim për korrigjimin e tij



Ish-kryeministri Mustafa ka vlerësuar se kundërshtarët e kësaj marrëveshje duhet ta pranojnë se i kanë marrë në qafë qytetarët e Kosovës, duke i privuar nga liberalizimi i vizave. "E ndiej të nevojshme, por edhe përgjegjësi para opinionit dhe anëtarësisë së LDK-së, t'i pyes edhe disa deputetë të LDK-së, partisë që unë e drejtoj, pse me aq popullizëm e kundërshtuan demarkimin kur LDK-ja ishte në krye të Qeverisë, e me aq dashuri e votuat kur LDK-ja u rrëzua nga Qeveria. Pse nuk po iu dëgjohet zëri sot? Pse sot s'po kërkoni që kufiri të kthehet në Çakorr e në Zhlep? Çfarë ndodhi me ju? Kush ju qiti fall? Pranojeni, gjithë ju, se e keni pasur vetëm për vota dhe pushtet. Pranojeni edhe fajin që i morët në qafë qytetarët dhe i privuat nga liberalizimi i vizave për shkak të egos tuaj", ka shkruar Mustafa.

Edhe më i ashpër me kryeministrin ka qenë kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, duke thënë se Haradinaj dha 8 200 hektarë tokë për një karrige. "Sot u bë një vit prej kur u ratifikua demarkacioni 'Meha' në Kuvend, ndërkaq nesër bëhen 400 ditë të marrëveshjes 'korrigjuese' Thaçi-Vujanoviq. Për ironi, në Ditën Ndërkombëtare të Pyjeve, më 21 mars, iu dhanë 8 200 hektarë Malit të Zi. 80 vota kurrsesi nuk do t'i bënin atë ditë pa këtë mashtrimin me korrigjim kufiri. Marrëveshja e Podgoricës e pranonte gabimin, por mashtronte se do ta korrigjonte atë. Një vit më vonë as që është formuar Trupi i Përbashkët Punues për të cilin thuhej se do ta kthejë kufirin në Çakorr e Zhlep e me Bjelluhën brenda Kosovës", ka shkruar Kurti në profilin e vet në "Facebook". Sipas tij, ratifikimi i kësaj marrëveshje ishte zdrukthetari e jo demokraci. "Nuk është turp nëse deputetët thonë se janë mashtruar. Turpi i përket mashtruesit. Mirëpo, nëse cilido pas mashtrimin, për

shkak të egos, nuk pranon se ka qenë i mashtruar, atëherë bëhet bashkëfajtor. Ratifikimi ishte zdrukthetari e jo demokraci. Nga pyjet e atyre 8 200 hektarëve u nxor sall një karrige kryeministri", ka shkruar Kurti.

Në njëvjetorin e ratifikimit të kësaj marrëveshje, Kosovën e ka vizituar ministri i Punëve të Jashtme të Malit të Zi, Srdjan Darmanoviq, i cili ka thënë se Kosova dhe Mali i Zi nuk kanë asnjë çështje të hapur. "Problemi është i zgjidhur. Nuk e shohim si çështje të hapur mes dy vendeve. Nuk ka pika kontestuese", ka thënë Darmanoviqi pas takimit me homologun e vet Behgjet Pacolli.

Kryeministri Ramush Haradinaj nuk ka dashur ta komentojë shumë këtë çështje. Ai ka ironizuar me karrigen në zyrën e tij. Gjatë pritjes së ministrit të Jashtëm malazez, Srdjan Darmanoviq, ai ka thënë se nuk e ka ndërmend t'i ndërrojë ulëset në zyrën e tij. "Po më kritikojnë për karrige. Ia kam dhënë fjalën Isës se nuk i ndërroj. Dua t'i lë këtu derisa ai të kthehet. Pra, tash po ia ruaj derisa të vijë. Të njëjtat i ka", ka thënë Haradinaj.

Korrigjimi i kufirit me Malin e Zi nuk varet vetëm nga puna e komisionit

Anëtar i Komisionit Shtetëror për Shënimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit, Riza Smaka, ka deklaruar se ky komision është i gatshëm për ta filluar punën për korrigjimin e marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi. Ditë më parë në një intervistë për gazetën "Epoka e re" ai pati deklaruar se tani është në dorë të Qeverisë që ta nisë këtë proces. Smaka ka deklaruar se nuk ka ndonjë informatë se kur mund të nisë ky proces. "Qeveria ka marrë përsipër për të formuar ekip të përbashkët

punues me palën malazeze për shënjimin e vijës kufitare Kosovë - Mal i Zi. Ndërsa ne nga aspekti profesional dhe teknik jemi të përgatitur çdoherë që ta bëjmë punën tonë. Në këtë drejtim edhe kryesuesi i komisionit, profesor Bulliqi, ka deklaruar se komisioni është i gatshëm, kurse qeveria tani e ka topin në dorë", ka thënë Smaka.

Ai ka shprehur optimizëm se do të mund të korrigjohet kjo marrëveshje, duke shtuar se komisioni ka argumente të mjaftueshme për këtë. Megjithatë, Smaka ka treguar se tani nuk varet çdo gjë prej punës së komisionit. "Po të ishte kjo çështje nën autorizimin tonë si komision, ne jemi aq të fuqishëm me argumente sa do të kishim shumë lehtë ta rirregullonim këtë çështje. Tani e kemi të metën që Kuvendi e ka ratifikuar këtë marrëveshje dhe tani varet shumë prej pikëpamjeve politike të të dyja qeverive. Po e përsëris edhe një herë, se këto janë qëndrime të mia personale, sepse në emër të komisionit flet kryesuesi, profesor Bulliqi", ka thënë Smaka.

Më 21 mars 2018 deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë ratifikuar marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi të nënshkruar në vitin 2015. Ndonëse sa ishte në opozitë rreshtojë krahi kritikëve më të ashpër të demarkacionit, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, pasi u zgjodh kryeministër, e përkrahi ratifikimin e kësaj marrëveshje.

Ndryshimi i qëndrimit të tij erdhi vetëm pas nënshkrimit të një deklarate në mes të presidentëve të Kosovës dhe Malit të Zi, në të cilën thuhej se palët pajtohen që një trup punues t'i identifikojë dhe t'i adresojë mosmarrëveshjet eventuale rreth shënjimit të kufirit. Me gjithë gatishmërinë e komisionit shtetëror për t'u marrë me këtë çështje, Qeveria e Kosovës edhe pas një viti të ratifikimit të kësaj marrëveshje nuk ka vendosur të ndërmarrë ndonjë hap në këtë drejtim.

rrugë, u gjuajt bombë në ndërtesën e RTK-së dhe te kryetari i Komisionit Shtetëror për shënjimin e vijës kufitare", ka shkruar Mustafa në profilin e vet në "Facebook", duke shtuar se kur ai ishte kryeministër, edhe eskorta e tij disa herë është sulmuar me mjete të ndryshme për këtë çështje. "Kufiri mbeti aty ku ishte me marrëveshje. Shpejt Bulliqi, i cili me një grup i doli në krahi z. Haradinaj për kauzën e tij të

rrejshme, u bë kryetar i Komisionit, e z. Haradinaj, kryeministër. Tani heshtin, nuk veprojnë, veçse e ushqejnë me para Komisionin. Heshtin të gjithë ata që i zinin ekranet televizive dhe mediet e tjera kundër marrëveshjes së demarkacionit. Heshtin edhe deputetët të cilët atëherë me popullizëm të pashoq kundërshtonin marrëveshjen. Disa prej tyre edhe tani deputetë e disa jo", ka shkruar Mustafa.

O'Connell mbështet AKK-në

PRISHTINË, 21 MARS (ER) - Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK), Shaip Havolli, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Ruairi O'Connell, me të cilin ka diskutuar për punën që është duke bërë Agjencia Kundër Korrupsionit në fushën e ndryshimeve legislative, procesin e deklarimit të pasurisë së

zyrtarëve të lartë, konfliktit të interesit, si dhe për forcimin e mekanizmave aktualë të Agjencisë për parandalimin dhe luftimin sa më efikas korrupsionit. Ambasadori O'Connell ka konfirmuar mbështetjen Ambasadës së Britanisë së Madhe për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe ka theksuar se vlerëson punën me përkushtim

të këtij institucioni. Britania e Madhe do të vazhdojë ta mbështesë Agjencinë Kundër Korrupsionit përmes projekteve të ndryshme në mandatin e saj parandalues.

Në takim u diskutua edhe për progresin e arritur nga Agjencia Kundër Korrupsionit karshi zotimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës të dhëna gjatë Samitit të Londrës (2019).



SBASHK-u i vendosur që orët e humbura gjatë grevës mos të zëvendësohen

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka bërë me dije se orët e humbura gjatë grevës nuk do të zëvendësohen as të shtunave, as në pushimin pranveror dhe as në fundvit.

"Pavarësisht se vendimi i gjykatës mund të vonohet me vite, kjo vendosmëri e udhëheqësve sindikalë dhe kryesisë së SBASHK-ut qëndron në bindjen e tyre, se asnjë dokument juridik nuk na obligon për mbajtjen e orëve të humbura gjatë grevës", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 MARS - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka mbajtur një takim me të gjithë kryetarët e sindikatave komunale të arsimit parauniversitar, nga i cili takim në mënyrë unanime është kërkuar që të zbatohet vendimi i Këshillit Drejtues i SBASHK-ut që orët e humbura gjatë grevës mos të zëvendësohen as të shtunave, as gjatë pushimit pranveror e as në fundvit. "Pavarësisht se vendimi i gjykatës mund të vonohet me vite, kjo vendosmëri e udhëheqësve sindikalë dhe e kryesisë së SBASHK-ut qëndron në

bindjen e tyre se asnjë dokument juridik nuk na obligon për mbajtjen e orëve të humbura gjatë grevës e aq më tepër ku secili mësimitdhënës në kontratën individuale të punës ka për obligim t'i mbajë 20 orë mësimore në javë. Këto 20 orë mësimore të realizohen nga e hëna deri të premten", është bërë me dije në komunikatën e SBASHK-ut.

Sipas kësaj komunikate, gjatë raportimit nga kryetarët e sindikatave komunale u vërejt se një numër i komunave përmes drejtorëve të arsimit dhe drejtorëve të shkollës janë duke u bërë presion mësimitdhënësve dhe nxënësve në forma të shantazheve për t'i detyruar që të mbahet mësimi të shtu-

nave. "Përmes kësaj komunikate edhe një herë u drejtohem i udhëheqësve komunalë, gjegjësisht kryetarëve të komunës dhe drejtorive arsimore, që mos të bëjnë presion te mësimitdhënësit për mbajtjen e orëve gjatë ditës së shtunë sepse ata kështu po shkelin kontratën e punës që e kanë lidhur vetë komunat me punëtorët e arsimit e që, siç e cekëm më lart, mësimitdhënësit duhet t'i mbajnë 20 orë mësimore në javë", thuhet, ndër të tjera, në komunikatën e SBASHK-ut.

SBASHK-u i ka siguruar mësimitdhënësit se do të jetë i vendosur që të drejtën e tyre për moskompensimin e orëve mësimore gjatë grevës do ta mbrojë deri në fund dhe se

kërcënimet që do t'u ndalen mëditjet nëse nuk punohet të shtunën nuk kanë asnjë bazë ligjore, por janë vetëm kërcënime për të tentuar që përmes frikës t'i detyrojnë mësimitdhënësit të punojnë. "Gjithashtu, kërkojmë nga kryetarët e shoqatave sindikale të jenë këmbëngulës për zbatimin e vendimit të Këshillit Drejtues të SBASHK-ut. Apelojmë tek anëtarët e SBASHK-ut që të jenë të bashkuar për zbatimin e vendimeve të organeve të SBASHK-ut ashtu siç ishin gjatë realizimit të grevës. I bëjmë apel ministrit Bytyqi që ta tërheqë vendimin për zëvendësimin e orëve të humbura gjatë grevës, sepse ky vendim e ka çrregulluar procesin mësimor edhe gjatë

ditëve të tjera të punës", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut.

Ky institucion ka falënderuar disa këshilla të prindërve që përkrahin vendimin e SBASHK-ut që mos të zëvendësohen orët mësimore gjatë fundjavës, por edhe gjatë pushimit pranveror. "I sigurojmë prindërit se anëtarësia e SBASHK-ut, pra mësimitdhënësit e fëmijëve tuaj, do ta japin maksimumin e mundshëm që fëmijët tuaj t'i arrijnë njohuritë e parapara për këtë vit shkollor, por jo duke punuar vikendeve dhe pushimit pranveror, sepse për humbjen e këtyre orëve mësimore mësimitdhënësit nuk janë fajtorë", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut.

Ministri Mustafa takon përfaqësuesit e bashkësive fetare në Kosovë

PRISHTINË, 21 MARS (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, në kuadër të aktiviteteve të bashkëpunimit, ka mbajtur takime me përfaqësuesit e bashkësive fetare në Kosovë. Në kuadër të këtyre takimeve ministri Mustafa ka vënë në pah ngritjen e mëtejme të kulturës së respektit në mes të besimeve fetare në Kosovë, si një ndër vlerat ekzistuese që vazhdojnë të kultivohen në vendin tonë në respekt të njëri-tjetrit.

Ministri Mustafa ka dëgjuar nga afër shqetësimet që kanë përfaqësuesit e bashkësive fetare, duke ofruar mbështetjen e tij si ministër dhe të agjencive të zbatimit të ligjit në Kosovë, për parandaluar çfarëdo rasti apo incidenti që mund të cenonte sigurinë në Kosovë. "Organet e rendit janë duke bërë punë shumë të mirë për ofrimin e sigurisë së përgjithshme dhe është e rëndësishme që kjo të reflektohet në perceptimin e qytetarëve për konceptin e sigurisë që, pavarësisht çka punojnë apo përfaqësojnë, të ndihen të sigurt", ka thënë ministri Mustafa.

Në këto takime Mustafa ka vlerësuar angazhimin e përfaqësuesve të bashkë-



sive fetare në Kosovë për rolin e tyre që kanë pasur në pjesëmarrje të forumeve të sigurisë në Kosovë, që kanë ndikuar drejtpërdrejt te qytetarët besimtarë që ta mbajnë vijën e besimit dhe ta parandalojnë radikalizmin e mundshëm, me qëllim që më pastaj të mos reflektohet në sigurinë e të tjerëve.

Përfaqësuesit e bashkësive fetare vlerësuan angazhimin e ministrit Mustafa dhe u shprehën të gatshëm të jenë në dispozicion në kuadër të përgjegjësisë që kanë për të ndihmuar në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme të gjithë besimtarëve në Kosovë. Komunikimi me bashkësitë fetare identifikon nevojën për t'i diskutuar hapur shqetësimet dhe nevojat e dyanshme. Ky komunikim do të ndihmojë në përmirësimin e jetës së njerëzve dhe besimeve, në mënyrë që qytetarët të kenë siguri dhe ta respektojnë njëri-tjetrin pavarësisht prej dallimeve apo besimeve që kanë.

Sot i jepet lamtumira e fundit nënës së heroit Edmond Hoxha

JUNIK, 21 MARS (ER) - Pas një sëmundje, të enjten ka ndër-ruar jetë nëna e heroit të kombit Edmond Hoxha, Nurije Hoxha. Varrimi i së ndjerës do të bëhet sot (e premte) në orën 14:00 në varrezat e qytetit të Junikut. Ngushëllime familjes Hoxha i kanë shprehur liderët shtetërorë.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka thënë se me dhimbje ka pranuar lajmin për ndarjen nga jeta të lokes Nurije Hoxha, nënës së heroit të kombit Edmond Hoxha. "Me dhimbje mora lajmin për vdekjen e lokes Nurije Hoxha, nëna e heroit të kombit Edmond Hoxha. Një nënë e madhe, që do të mbetet përgjithmonë emër i nderuar në historinë e lirisë sonë", ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryeministri Ramush Haradinaj e ka prekur lajmi për kalimin në amshim të nënës Nurije, nënës së heroit Edmond Hoxhaj, luftëtarit të ditëve të para të UÇK-së. "Një nënë fis-



nike e bujare që lindi, rriti dhe edukoi një trim dhe luftëtar të paepur të lirisë si Edmond, e meriton respektin tonë të përjetshëm", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook", duke i shprehur ngushëllime familjes Hoxha. "Ngushëllime të sinqerta familjes Hoxhaj dhe të gjithë atyre që e njohën nga afër nënën Nurije. Pushoftë e qetë në tokën e Kosovës!", ka shkruar Haradinaj.

Drenasi bëhet komuna e 16 në Kosovë në të cilën fillon programi i vizitave shtëpiake për nëna dhe fëmijë prej 0 deri në 3 vjeç

Veseli: Reformat në sektorin e shëndetësisë kanë filluar

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, i shoqëruar nga ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili dhe shefi i UNICEF-it në Kosovë, Murat Sahin, kanë përfunduar të enjten në Drenas nisjen e programit të ri shëndetësor për vizitat e mjekëve nëpër shtëpitë e nënave shtatzëna dhe atyre që kanë lindur. Veseli ka thënë se tanimë reformat në sektorin e shëndetësisë kanë filluar



Kuvendit, duke falënderuar UNICEF-in për mbështetjen e këtij projekti dhe projekteve të tjera.

Gjatë takimit me personelin shëndetësor në Drenas dhe bashkëbisedimit me mjekë dhe infermierë, ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, i ka siguruar ata se në vitin e ardhshëm në Drenas do të ndërtohet një objekt i ri për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Ismaili ka thënë se reformat në shëndetësi do të vazhdojnë, duke shtuar kujdesin shëndetësor për pacientët, por edhe duke përmirësuar kushtet për personelin shëndetësor.

I pranishëm ishte edhe kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, i cili ka falënderuar kryeparlamentarin Veseli dhe ministrin e Shëndetësisë për mbështetjen e Komunës së Drenasit.

Drenasi është komuna e 16 ku ka nisur zbatimin e këtij programi, i hartuar në bashkëpunim me UNICEF-in.

Drejtori i kësaj organizate në Kosovë, Murat Sahin, ka thënë se vizioni i UNICEF-it është që çdo fëmijë të ketë jetë të shëndetshme, pastaj edhe arsim më të mirë. "Partneriteti që kemi në Kosovë me ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili, është model edhe për vende të tjera. Ky program ka për qëllim që secila grua shtatzënë dhe nëna që ka lindur fëmijë, t'i kenë gjatë dy vjetëve shtatë vizita të mjekëve në shtëpitë e tyre. Gjatë 2018-s në mbarë komunat ku e realizojmë këtë projekt janë kryer mbi 15 mijë vizita në shtëpi. Dua ta falënderoj kryetarin e Kuvendit i cili na ka mbështetur vazhdimisht për realizimin e programeve tona në Kosovë", ka thënë shefi i UNICEF në Kosovë, Murat Sahin.

Kryeparlamentari Veseli, i shoqëruar nga ministri i Shëndetësisë dhe mjekë të QKMF-së, ka vizituar edhe një familje, për ta parë nga afër zbatimin e këtij projekti i cili është mirëpritur nga nënat shtatzëna.

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

DRENAS, 21 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, së bashku me ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili, dhe shefin e UNICEF-it, Murat Sahin, të enjten në Drenas kanë përfunduar nisjen e programit të ri shëndetësor për vizitat e mjekëve nëpër shtëpitë e nënave shtatzëna dhe atyre që kanë lindur, duke ua lehtësuar shërbimet shëndetësore.

Kryeparlamentari Veseli ka thënë se nëpërmjet këtij projekti po shkohet drejtpërdrejt te qytetarët dhe familjet, fillimisht nëpërmjet qendrave të mjekësisë familjare. "Kjo është një politikë dhe një strategji për të cilën e përgëzoj ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismaili, i cili është duke e bërë mirë punën e vet. Është e rëndë-

sishme që kemi filluar reformat në sektorin e shëndetësisë. Nuk ka qenë e lehtë të bëhen ndryshimet e deritashme qoftë në përmirësimin e kushteve të punës, qoftë në përmirësimin e kushteve materiale të stafit shëndetësor", ka thënë Veseli.

Ai ka shtuar se puna e nisur nuk do të ndalet dhe ministri Ismaili ka një vizion të qartë për transformimin rrënjësor të sistemit shëndetësor, për të siguruar shërbime të shpejta dhe cilësore për qytetarët tanë. "Ne do të jemi te pacienti, te qytetari. Jemi të vetëdijshëm që ende, edhe sot, edhe pse ka përmirësime, qytetarët ballafaqohen me disa mungesa të barnave esenciale, por ne do të jemi përkrah tyre deri në fund. Nuk do të lejojmë të ketë mjekë të papunë, ndërsa në anën tjetër të ketë mungesë të mjekëve nëpër klinika", ka thënë kryetari i



LDK-ja kërkon seancë të jashtëzakonshme për lojërat e fatit

PRISHINË, 21 MARS (ER) - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka dorëzuar të enjten kërkesën në Kuvend për seancë të jashtëzakonshme lidhur me pezullimin e aktiviteteve të lojërave të fatit dhe kazinove. "Ngjarjet tragjike të javës së fundit, ku në ambiente të kazinove-lojërave të fatit mbetën të vdekur dy të rinj, duket qartë se nuk janë raste të izoluar. Ekziston rreziku që ngjarje të tilla të shndërrohen në fenomen. Mbrojtja e qytetarëve, ofrimi i sigurisë dhe ambientit të qetë janë

përgjegjësi të shtetit të Kosovës. Prandaj, është detyrë parësore e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta adresojnë me urgjencë këtë fenomen përmes seancës së jashtëzakonshme. Mosveprimi i institucioneve përkatëse shtetërore në këtë moment do ta vështirësojë adresimin e këtij problemi më vonë", është thënë në njoftimin e LDK-së.

Lidhur me këtë, Grupi Parlamentar i LDK-së ka vlerësuar se është e nevojshme që

Kuvendi i Republikës së Kosovës ta shprehë qëndrimin e vet lidhur me këto ngjarje dhe të kërkojë nga Qeveria që menjëherë t'i pezullojë aktivitetet e kazinove dhe lojërave të fatit, në mënyrë që ngjarje të tilla të mos përsëriten më. Duke pasur parasysh rëndësinë dhe urgjencën e kësaj çështjeje, grupi parlamentar i LDK-së, i mbështetur nga disa grupe parlamentare dhe deputetë të pavarur, ka kërkuar që seanca e jashtëzakonshme të mbahet sot (e premte) në orën 11:00.



OAK-u: Projektligji i punës lë shumë hapësirë për përmirësime

PRISHTINË, 21 MARS (ER) - Analiza e Projektligjit të punës dhe rekomandimet e Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) ishin qëllimi i konferencës për media të mbajtur të enjten nga zyrtarët e kësaj ode.

Qëndresa Ibrahim, koordinatore në OAK, ka theksuar se Projektligji i punës ka për qëllim t'i rregullojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. "OAK-u konsideron se ky projektligj lë shumë hapësirë për përmirësime dhe ndryshime, të cilat duhet të inkorporohen me qëllim që pas miratimit të Projektligjit të punës, ai të jetë i zbatueshëm në praktikë e të mos mbetet vetëm në sirtar", ka thënë Ibrahim.

Ndërsa Vanesa Gashi, zyrtare e OAK-së, ka deklaruar se ky projektligj synon avancimin e të drejtës së punëtorëve dhe bizneseve dhe rregullimin e një



varg çështjesh në fushën e marrëdhënies së punës sipas standardeve ndërkombëtare dhe rrethanave socio-ekonomike të

vendit. "Ne si OAK kemi bërë kërkesa të vazhdueshme për intervenim adekuat në ligj, duke propozuar seminare treditore me

palët e interesit, mirëpo kjo kërkesë nuk është marrë parasysh", ka thënë ajo. Gashi ka theksuar se, sipas Entit

të Statistikave, numri i papunësisë në Kosovë është në nivel të lartë. Sipas saj, e vetmja shpresë për këtë vend është sektori privat, duke marrë parasysh se në sektorin publik vendet e punës janë të stërngarkuara. "Gjithashtu, punonjësit e institucioneve publike janë shpenzues të buxhetit të shtetit ndërkohë që sektori privat, përveç që siguron të ardhura, kontribuon edhe në rritjen e të hyrave në shtet nga tatimet dhe fitimet e bizneseve. Prandaj ne si OAK, në bashkëpunim me institucionet qeveritare, duhet t'u krijojmë një klimë të re dhe pozitive bizneseve në Kosovë, do të thotë lejinim e zhvillimit të veprimtarisë në sektorin privat, pasi në këtë mënyrë edhe mundësitë janë më të mëdha për vende të reja të punës dhe rritje ekonomike të vendit", ka thënë Gashi.

Implementimi i tatimit në toka, një nga reformat më të rëndësishme për komunat

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 MARS - Komiteti Drejtues i projektit 'Pro Tax 2' ka mbajtur të enjten takimin e radhës të kryesuar nga ministri i Financave, Bedri Hamza. Në këtë takim pjesëmarrës ishin edhe kryetari i Komunës së Podujevës, Agim Veliu, përfaqësuesit e Ambasadës së Suedisë në Kosovë, përfaqësues të SIDAS-së, si dhe përfaqësues të komunave të tjera. Në këtë takim pjesëmarrësit i vlerësuan lart rezultatet e arritura të projektit 'Pro Tax 2', me theks të veçantë implementimi i tatimit në toka, si një nga reformat më të rëndësishme për komunat e

Kosovës.

Me këtë rast, ministri Bedri Hamza, duke falënderuar partnerët nga Ambasada e Suedisë dhe SIDA suedeze për vazhdimin e mbështetjes dhe bashkëpunimit në këtë projekt, ka theksuar se Ministria e Financave i ka kushtuar vëmendje të shtuar reformës së tatimit në pronë, me fokus të veçantë në zbatimin e tatimit në tokë, për shkak të rëndësisë madhore të këtij projekti për komunat e Kosovës dhe jo vetëm. Sipas tij, edhe pse është një proces teknikisht shumë sfidues, mund të them se ia kemi dalë ta fillojmë zbatimin e tatimit në toka. "Jemi në rrugë të mbarë për sa i përket



plotësimit të kuadrit ligjor me aktet e nevojshme nënligjore. Para dy javësh është miratuar një akt tjetër nënligjor mjaft i rëndësishëm për procesin,

Udhëzimi Administrativ për Procedurat e Ankimit. Udhëzimi ka një rëndësi themelore për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të

tatimpaguesve si dhe përmirësimin e mëtejshëm të të dhënave në regjistrat e tatimit në pronë", ka thënë ministri Hamza.

Suhareka nis peticionin për shfuqizimin e Ligjit për lojërat e fatit

SUHAREKË, 21 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka thënë se, ashtu siç ka paralajmëruar, të enjten ka iniciuar peticionin për shfuqizimin e Ligjit për lojërat e fatit. Ai ka thënë se në këtë në këtë rrugëtim janë bashkë dhe të vendosur me të gjitha subjektet politike të Komunës së Suharekës. "Ftoj të gjitha subjektet politike, OJQ-të dhe secilin prej jush, ta nënshkruajmë peticionin, në pikat që vendosen sot në qytet, Mustrisht dhe fshatra të tjerë", ka thënë Muharremaj. Ai ka kërkuar edhe nga kryetarët e komunave të tjera që t'u bashkëngjitet apo edhe të vetorganizohet



hen për shfuqizimin e ligjit përmes një peticioni qytetar, ku do t'i dorëzohet Parlamentit të Kosovës. "Ne jemi të vendosur dhe jemi gjithmonë në mbrojtje të sigurisë dhe interesave të qytetarëve", ka thënë Muharremaj.

50 gra dhe vajza i bashkohen Vetëvendosjes në Vushtrri

VUSHTRRI, 21 MARS (ER) - Lëvizja Vetëvendosje ka bërë me dije se gratë dhe vajzat gjithandë nëpër Kosovë po i bashkohen kësaj lëvizje. Sipas LV-së, në Vushtrri këtë javë janë anëtarësuar rreth 50 gra dhe vajza. Anëtarët e reja janë pritur nga nënkryetarja e Lëvizjes dhe deputetja Fatmire Kollçaku, drejtuesja e Sekretariatit të Gruas Aktiviste, Nazlie Bala, dhe nga Fjolla Ujkani, drejtuese e Sekretariatit të Gruas Aktiviste në nivel qendror. "Në vazhdim e aktiviteteve të muajit mars, në secilën qendër të Lëvizjes Vetëvendosje për çdo ditë gratë dhe vajzat po bashkohen dhe aktivizohen në Lëvizje.



Në Vushtrri u mbajt tubimi me rastin e anëtarësimit të rreth 50 grave dhe vajzave në Lëvizjen Vetëvendosje. Zgjerimi i organizatës dhe marrja pjesë edhe e grave në të është dëshmi se barazia gjinore është e mundur", ka njoftuar Vetëvendosje.

Kosova dhe Mali i Zi nënshkruajnë marrëveshje në fushën e kontrollit të mallrave strategjike

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 MARS - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës dhe Ministria e Ekonomisë e Malit të Zi kanë nënshkruar të enjten memorandum bashkëpunimi në fushën e kontrollit të mallrave strategjike me qëllim të përforsimit të bashkëpunimit në fushën e kontrollit të tregtisë së armëve dhe pajisjeve ushtarake, armëve konvencionale, armëve të shkatërrimit në masë, si dhe eksportit të mallrave me përdorim të dyfishtë.

Memorandumi është nënshkruar në nivel sekretarësh, duke theksuar nevojën për të bërë përparime në shkëmbimin e informacionit dhe përvojave në çështjet e transferimit ndërkombëtar të kontrollit të mallrave

strategjike.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka theksuar se ky memorandum është edhe një hap tutje për thellimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi, duke shtuar se memorandumet tilla do të bëhen edhe me vendet tjera fqinje.

Ndërsa sekretari i MTI-së, Burim Rreci, ka theksuar gatishmërinë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për bashkëpunim në fushën e mallrave strategjike që del edhe si obligim nga Bashkimi Evropian. Rreci ka thënë se forcimi i kontrollit kufitar është interes i shtetit të Kosovës.

Një marrëveshje e tillë është nënshkruar edhe me Shqipërinë.

"Një marrëveshje e tillë e kemi nënshkruar me Shqipërinë. Së shpejti do ta nënshkruajmë



edhe me Kroacinë dhe Maqedoninë", ka thënë Rreci. Ndërsa Milan Srzentic, sekretar

shtetëror në Ministrinë e Ekonomisë të Malit të Zi, ka thënë se ky memorandum ka

rëndësi të veçantë për dy shtetet, për shtimin e bashkëpunimit dhe kontrollit kufitar.

Matoshi dhe Ahmeti koordinojnë projektet për Prishtinën

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 21 MARS - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, ka pritur të enjten në takim kryetarin e Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, së bashku me nënkryetarin Selim Pacolli dhe bashkëpunëtorët e tij. Në këtë takim është diskutuar për bashkëpunimin në mes të dy institucioneve, në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapësinor, projektet e përbashkëta, duke përfshirë hartën zonale, krijimin e zonave të gjelbra, veturat elektrike, deponinë e materialeve të ngurta si dhe për tema të tjera.

Në një konferencë të përbashkët për medie, ministri i MMPH-së, Fatmir Matoshi, ka thënë se bashkë me Komunën e Prishtinës do të financojnë shumë projekte, në mesin e tyre edhe hartën

zonale që, sipas tij, është një dokument shumë i rëndësishëm në fushën e planifikimit. "Ne jemi pajtuar që bashkë me komunën të përfshihemi në projektin e hartimit të hartës zonale dhe MMPH-ja do ta mbështesë komunën në këtë drejtim. Do të vazhdojmë të jemi përkrahë komunës në fazën e përcaktimit të lokacionit të deponisë së materialeve të ngurta dhe do ta mbështesim edhe në mënyrë financiare", është shprehur Matoshi.

Ai ka thënë se MMPH-ja do t'i realizojë në Prishtinë edhe projektet: trajtimi i ujërave të zeza, krijimi i gjelbërimit vertikal, krijimi i zonave të gjelbra, si dhe rregullimi i disa shtretërve të lumenjve. "Kemi pasur kërkesë nga komuna për ta mbështetur me një kamion për lëvizjen e drunjve dhe ky është një projekt që ministria do ta mbështesë. Një problem tjetër ka të bëjë edhe me dheun që nxirret



me rastin e ndërtimeve dhe ne duhet të gjejmë një vend ku ta

deponojmë, dhe për këtë do ta përcaktojmë edhe lokacionin.

Jemi marrë vesh që për këto projekte në një të ardhme të afërme të nënshkruajmë edhe memorandumet bashkëpunimi me Komunën e Prishtinës", ka theksuar Matoshi.

Ndërsa kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se të gjitha këto projekte kanë rëndësi të veçantë për kryeqytetin. "Ajo çfarë dua të potencoj është procesi i hartës zonale të komunës. Ne i kemi përfunduar të gjitha punët përgatitore dhe ideja ka qenë që ta kërkojmë ndihmën e MMPH-së për shkak që në këtë ministri gjendet një kapacitet i jashtëzakonshëm që na ndihmon në përfundimin e këtij procesi. Pra, kjo ka qenë për mua pjesa më e rëndësishme", është shprehur Ahmeti, duke shtuar se Komuna e Prishtinës do të ketë edhe dy stacione për mbushjen e makinave elektrike, bashkëpunim ky me USAID-in dhe MMPH-në.

ATK-ja, shembull i mirë sa i përket menaxhimit dhe parandalimit të konfliktit të interesit

PRISHTINË, 21 MARS (ER) - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka pritur në takim grupin e punës së përbërë nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu dhe Hajdar Beqa, të cilat monitorojnë zbatimin e Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e kon-


fliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në takim drejtori i ATK-së ka informuar grupin e punës për procedurat dhe rregullat që zbatohen në funksion të parandalimit të konfliktit të interesit, të cilat rezultojnë se ATK-ja është një hap para Ligjit nr. 06/L-011. Po ashtu, drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka

garantuar deputetët se çdoherë ATK-ja ka trajtuar dhe do t'i trajtojë me prioritet të gjitha rastet që lidhen me këtë fushë. Ndërsa deputetët kanë theksuar se ATK-ja është një institucion shembull i mirë sa i përket menaxhimit dhe parandalimit të konfliktit të interesit për ushtrimin e funksionit publik.



Korrigjimi i 'lehtë' i kufijve dhe degradimi i rëndë i Kosovës!



Behxhet Sh. SHALA - THAÇI

A është e realizueshme zgjidhja e ushkurit kufitar: Njeriu i mençur edhe problemin më të madh e bën lehtë të menaxhueshëm dhe të papërfillshëm, kurse budallai edhe fijen e barit e bën si trashësia e trarit. Kosova, 20 vjet pas përfundimit të luftës dhe 11 vjet pas shpalljes së pavarësisë, u gjet në rolin e budallait duke diskutuar për tërësinë territoriale, si hap i parë, pastaj edhe për sovranitetin, si hap i dytë, për të përfunduar edhe për statusin politik dhe subjektivitetin ndërkombëtar si përfundim logjik dhe i pashmangshëm nëse bëhen hapat e parë dhe të dytë. Fjalët që i tha Nil Armstrongu kur e shkeli për herë të parë Hënë: "Se ky është hap i vogël për njeriun, por është hap i madh për njerëzimin...", e bëri dhe po e bën presidenti Thaçi në Kosovë me propozimin me shumë koka; për ndërrim teritorësh, korrigjim kufijsh, ndryshim kufijsh apo korrigjim i lehtë i kufijve dhe, sipas parafrazimit të Armstrongut: "Ky është hap i vogël për Kosovën, por është hap i madh për Serbinë...". Kjo lojë e ndryrë për dhe rreth kufijve i ka kushtuar dhe po i kushton shumë Kosovës për faktin se të gjitha aktivitetet, debatet, dialogët, monologët dhe tensionet brendapolitike dhe brendakombëtare po sillen rreth ushkurit të kufijve! Presidenti Thaçi po e luan lojën e pander-shme falë kotillës politike që e rrethon për të cilën fe, komb, atdhe, njerëzillëk dhe moral është mbushja e xhirollogarisë me euro, dollarë, lira turke, denarë të Gruevskit dhe dinarë të Vuçiqit, nuk ka aspak rëndësi dhe të cilët mercenarizmin e kanë shndërruar në art të imoralitetit dhe nënshtrimit! Në kotillën përcjellëse të presidentit Thaçi janë bijtë dhe bijat më të përbotuara të patriotizmit jugosllav dhe serb, denoncues të shokëve të ilegales, kundërshtarë dhe sabotues të

luftës çlirimtare të cilët janë bindur se lufta është e nevojshme dhe e domosdoshme vetëm pasi kanë kaluar "kurën e Shopenhauerit - kurën e trajtimit me stupc druri...", dhe plehra tjerë që, edhe kur Shefi hesht, ata flasin në emër të Shefit. Këtij kori i është bashkuar edhe Edi nga Tirona, i cili po përpiqet ta luaj rolin e dragoit, jo duke nxjerrë tym dhe flakë nga goja por pordhë dhe fendë nga pjesa e prapme, si pasojë e dobësisë të muskujve shtrëngues të prapanicës. Këtë korrigjim apo ndryshim të kufijve po e përkrahin, deri në orgazëm, dyshi mashtrues i Brukselit, violinisti i dështuar nga Vjena apo Johanes Sebastian Han dhe kryesuesja e organizatës Cosa Nostra nga Brukseli, Donna Federika Mogerini që pretendon se e përfaqëson politikën e jashtme të këtij bashkimi shtetesh i quajtur BE. Edhe eksponentët të administratës Trap - Molton po e përkrahin këtë ide të presidentit gjenial, zotni Hashim Thaçi. Mos të flasin këtu për çetnikun demokrat, presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, që tani, si në përrallat e Andersonit, është lakuruar fare me kërkesën se Serbia nuk i pranon kufijtë në Jarinje dhe Bërnjak sikur edhe se Serbia duhet të fitojë diçka për të dhënë diçka! Dinak, kriminel dhe i marrë është Aca, i biri Fahriut! Fillimisht ishte caktuar afati prej 120 ditëve për pezullim të taksës, kërkesë nga armiqët ndërkombëtarë, kohë e mjaftueshme për arritjen e një marrëveshjeje "histerike - obliguese" midis Serbisë dhe Kosovës dhe kjo i tregon sa larg kishin ecur këmbakëmbës Hasha dhe Aca, Sanço Panço dhe Rosinanti i politikës ballkanike, me pretendime të protagonizmit global, si kreatorë dhe auditorë të historisë së ardhme. Taksa e Kadrisë dhe Enverit nga Gjiro - Reka, e që e mbajti dhe po e mbanë Rambo nga Glogjani, ishte pengesa kryesore e konkretizimit të kësaj marrëveshjeje që do të prodhonte një kostum elegant për Serbinë dhe një çefin (kostum për të vdekur) për Kosovën! Presioni për heqje të taksës ishte i madh, që nga firmi i presidentit Trump, te fatva e mashtruesve Mogerini - Han, nga Bororamizi i LDK-së, nga Xhaviti M16, nga presidenti leg-

jendar, Luani i Burojës, nga biseksualët politikë dhe moral të LDK-së dhe deri te arvanitasi i Kazakistanit, Gjet Macolli. Pastaj, kësaj kërkesë iu bashkëngjiten agresivisht Kuraci i Austrisë dhe Makaroni i Francës sikur edhe "tre gjermanët e trashë" të Angela Merkelit dhe Luanët e rrapkapitur dhe ekstraevropianë të shën Terezës May. Deri pra një javë kam qenë krah Ramushit 100 përqind për taksën por gjërat po ndryshojnë me dalje të kërkesave të reja, të pakundërshtueshme dhe në planin afatgjatë, të shëndetshme. Po kush ndikoi aq shumë te unë që të më luhatë qëndrimin?! Presidenti legjendar, ish shefi im i dikurshëm që ma morën padrejtësisht këta të PSD-së, Isa, "kërcënimi para muajit Ramazan" i presidentit Trump apo bileta për koncertin e 1 janarit 2020 të Filharmonisë të Vjenës e premtuar nga Kuraci i Austrisë?! Asnjëra, më besoni! Më bindi kërkesa e një ministri elokuent, ekstravagant, ekstraordinar, jashtëzakonisht inteligjent dhe atraktiv e që përfaqëson një superfuqi politike në Kosovë, ministri i AKR-së, Fatmir Matoshi - Leci. Dhe i takon kjo kërkesë e rëndësishme së jashtëzakonshme aq më parë që është ministër për mbrojtje të mjedisit më të ndotur politikë dhe moral në Ballkan dhe Europë! Kur e kam dëgjuar kërkesën e tij, më janë mbushur sytë me lot, kam pasur një aritmi (rrahje të shpeshtuar të zemrës) dhe gati se nuk i kam humbur ndjenjat! Vetëm dy herë në jetën time kam qenë në këtë situatë; herën e parë nga hidhërimi kur Behgjet Pacolli, presidenti më i mirë i të gjitha kohërave, që nga Piroja, Aleksandar Obrenoviç, kral Pjetri e deri te Karagjorgje Petroviç u detyrua që për shkaqe krejtësisht morale (kjo është e vetmja arsye që i bindet Begja) të dorëhiqet nga posti i presidentit. Rasti i dytë është i ministrit atraktivohiperaktiv, Fatmir Matoshi - Leci që, me fakte që nuk diskutohen, miqësia e përjetshme me Amerikën dhe për brekushet e Milicës, duhet të pezullohet taksa. Besoj se edhe Ramushi e ka dëgjuar këtë prononcim dhe do ta shqyrtojë me seriozitetin më të madh; jo për hatër të Trumpit por për shkak të gjenialitetit të mbrojtësit të mjedisit në Kosovë,

Fatmir Matoshi - Leci. Jam i dorëzuar në këtë drejtim.

A ka miqësi të përjetshme, sidomos në politikë: Sot kemi miq të ndryshëm; të shpirtit, të jetës, të idealit (na ishte dikur), të vuajtjeve, të aventurave, të politikës, të tenderëve të dallaveve, të interesit e sidomos të fejsbukut. Mjafton një klikim atraktiv dhe keni mundësi të zëni shumë miq. Prej qeverisë aktuale, me dëshirë do t'i bëja miq të përjetshëm vetëm dy ministra; Fatmir Matoshin - Lecin për shkak të elegancës që e ka, mençurisë së padiskutueshme dhe orientimit për mbrojtje të një ambienti skajshmërisht të ndotur. E keni parë se si vishet në mënyrë elegante, me një frizurë të punuar nga këmbët e Sellmës dhe një shikim prej Marlon Brandoje. Ministri i dytë është ministri i Drejtësisë, Abelardi. Kam lexuar se Abelardi ka qenë zot apo sinonim i Drejtësisë në vendet anglo-saksone e që është edhe te ne. Kjo është dëshirë e njëanshme apo, siç thotë një ministër (Gjeti Nacionale) që e çmoj shumë por që pakthyeshem e kam humbur miqësinë me te për fajin tim sigurisht, kjo miqësi është unilaterale apo jednostrane (shprehje e nostalgjikëve jugosllavë). Të tjerët ministra nuk i shlivati fort dhe, përveç respektit të madhe që e kam ndaj institucioneve dhe institucionalizmit tim antologjik, nuk kam asnjë ndjenjë tjetër. Besimin nuk e kam mik sepse aspak, përkundër emrit që e ka, nuk i besoj. Enverin, përkundër sinqeritetit dhe ndershmërisë që e karakterizojnë nuk e dua për shkak të Enver Hoxhës nga Gjykostra ndonëse ky është nga Suva Reka (Lumi i Thatë). Uranit i iku si djalli nga kryqi për shkak të Uraniumit të varfëruar. Bedriut ia kam frikën shkaku se kur isha fëmijë dhe çoban i improvizuar, për shkak të lëshimeve - neglizhencës profesionale (më hynin loptë në ara me grurë), polari Bedri më ka rrahur me shkop thane deri sa jam pshurrur. Edhe tash, kur edhe rastësisht e takoj Bedriun, iku me vrap deri te WC-ja më e afërt. Më ka lënë pasoja të përjetshme për fshikëzën urinare. Dhuratën e sotme e respektoj shumë për dallim të një Dhurate tjetër që më

shpuri deri te bunari dhe nuk më la të pijë as edhe një pikë uji. Në kohën time nuk kishte ujë Akulli apo Miros por vetëm ujë bunari dhe ujë nga Kroji i Hasan Agës. Ky Valdrini i KEDS-it dhe ZRRE-së po më përngjanë shumë në Valdrinin disejator, natyra shumë delikate. Kurse, ministri i Labit për Punë të Brendshme është rast tipik se: "kur mjekët hyjnë në politikë kryesisht e bëjnë m...skllotë". Më mirë i shkon uniforma e Papë Françeskut, se e ministrit për punë të brendshme. Ministri Lekaj vetëm emrin e ka të shenjtorit Shën Pali kurse Mahiri dhe Rasim Demiri janë minoritarë dhe, për hatër të Hashimit nuk e them të vërtetën se e kam nga frika) nuk po i kritikojë. Sidomos nuk mund të merrem me ministrat e Lista Serbe sepse hidhërohen shumë Hashimi dhe Aca, në njërin anë kurse, në anën tjetër mund edhe të më bëjnë më të butë shpinë se barkun, sikur që ia bënë Sllobës!

Nuk jam kundër luginasve: Hashim Thaçi më ka hasmëruar me luginasit (Hashimi është i përrnjve e jo luginasit) sepse ai qenka për bashkimin e Luginës me Kosovën, pa i dhënë Serbisë as edhe një qime të "opingave të rruara" kurse, unë po ju them se, sa i përket kësaj pune, nëse i besojnë Hashimit, atëherë i bie sikur të sillen "rreth dardhës së Ahmatit". Hiç nuk e besoj se mund ta marrim Luginën, por nuk e përjashtoj mundësinë që, në vend të një toke shumë të pasur të Veriut të Kosovës, mund ta marrim Tërrovcin e Madh me nja 112 xhami shtesë. Nëse Hashim Thaçi e merr Luginën e Preshevës, pa i dhënë asgjë Serbisë, botërisht premtot se do të shkoj zhagas, prej kryeqytetit të Luginës së Preshevës, deri në Burojë, duke e puthur çdo milimetër të tokës, për të vazhduar deri në Sukth të Tironës për t'ia puthur mbetjet koçore të Edvin Ramës e do të përfundoj në Hajvali për ta puthur çdo arterie, kapilar, nerv dhe neuron të arvanitasit Behgjet Pacolli. Nëse nuk e bëni këtë, unë e kam një kërkesë shumë më pak të kushtueshme dhe më të lehtë për këta tre musketarë: "Të m'i ruajnë opingat..."

Komuna do t'i mbulojë shpenzimet e varrimit për qytetarët e Skenderajt

SKENDERAJ, 21 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, nëpërmjet llogarisë së vet në "Facebook" ka bërë me dije se tash e tutje kjo komunë do t'i mbulojë shpenzimet për varrimin e qytetarëve të Skenderajt. Jashari ka thënë se për herë të

parë po fillon realizimi i projektit më përfitues i mundshëm për qytetarët e Skenderajt. "Të nderuar qytetarë të Skenderajt, jam tejet i lumtur t'juaj kumtoj lajmin që për herë të parë po fillon realizimi i projektit më përfitues i mundshëm për qytetarët tanë. Nga sot, secila

familje që do të ketë rast vdekjeje, përveç dhembjes, nuk do të ketë edhe barrën e organizimit të varrimit në aspektin teknik, si dhe shpenzimet financiare për varrim. Me një planifikim të mirë të buxhetit kemi siguruar mjetet financiare për t'i mbuluar shpenzimet e

domosdoshme, e që për raste të caktuara janë edhe të papërbalueshme", ka shkruar kryetari Jashari. Ky propozim i kryetarit Jashari ka marrë mbështetjen e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, të cilët i kanë rekomanduar Kuvendit për miratim.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ENGLAND - CZECH REPUBLIC

1

PORTUGAL - UKRAINE

1

ITALY - FINLAND

1-1

Kosova nuk koritet ndaj Danimarkës

Futbollistët "dardanë" e kanë regjistruar edhe lojën e njëmbëdhjetë pa humbje. Pavarësisht prej potencialit që ka Danimarka, Kosova në stadiumin "Fadil Vokrri" ishte superiore me paraqitje, kurse fitoren e lëshoi nga duart në minutat e fundit (2-2). Ky barazim është një motiv shtesë për ndeshjen e parë kualifikuese që Kosova e zhvillon të hënën ndaj Bullgarisë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka dëshmuar edhe një herë tjetër potencialin ndaj një kundërshtari të fortë siç ishte Danimarka, pasi miqësorja e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" përfundoi me rezultat të barabartë 2-2. "Dardanët" fare lehtë kanë mundur t'i gëzohen fitores, por një gabim në minutat e fundit bëri që ndeshja të përfundojë me rezultat të barabartë. "Mendoj se mund të jemi të lumtur me këtë ndeshje dhe qartë, ishte ndeshje intensive. Për mua, ekipi bëri punë shumë të mirë. Patëm disa raste të mira. Shënuam dy, pësuam dy kundër një ekipi shumë të fortë. Mendoj se ishte një performancë shumë e mirë ekipore dhe jam i kënaqur. Për mua rezultati s'ishte në plan të parë, por performanca ndaj një skuadre të fortë. Në mbrojtje ishim të mirë dhe po ashtu edhe në fazën ofensive. Patëm raste dhe treguam lojë të mirë. Kjo ishte më e rëndësishmja", ka deklaruar pas ndeshjes trajneri i Kosovës, Bernard Challandes. Kosova e nisi mirë ndeshjen dhe në minutën e shtatë u regjistrua një gjysmerast, kur Zeneli gjuajti nga distanca, por pa problem për portierin Schmeichel. Në minutën e 15-të, portieri i Kosovës, Arijanet Muriç, bëri një dalje të gabuar, por Larsen nuk e shfrytëzoi këtë rast. Pesë minuta më vonë Vedat Muriçi e fitoi një dyluftim, por në momentin kur pasoi në zonë ishte mbrojtja mysafire që intervenoi me sukses. Rasti më i mirë i Kosovës u regjistrua në minutën e 28, fillimisht Zeneli depërtoi bukur në zonën e kundërshtarit dhe e shërbeu për mrekulli Muriçin, i cili gjuajti afër shtyllës pingule. Goli i Kosovës erdhi pas një ndërprerje në minutën e 42-të, Besar Halimi harkoi dhe Amir Rahmani për mrekulli shkëputet në zonë për të kaluar vendasit në epërsi.



Stadiumi "Fadil Vokrri"
Shënues: Rrahmani (42), Celina (66) për Kosovën, Eriksen (63), Hoejbjerg (90) për Danimarkën
Shikues: 13500
Gjyqtarë: Ali Palabiyik, Serkan Olguncan, Cevdet Komurcuoglu (Turqi), Besfort Kasumi (Kosovë)
Kartonë të verdhë: Nuhiu (Kosova), Larsen, Ankersen (Danimarka)
Kosova: Muriç (Ujkani), Vojvoda, Rrahmani, Aliti, Paqarada, Halimi (Kastrati), Shala, Celina (Voca), Zeneli (Berisha), Rashica (Zhegrova), Muriçi (Nuhiu).
Danimarka: Schmaichel, Dalsgaard (Larsen), Christensen (Kjaer), Joergensen (Dolberg), Ankersen, Hoejbjerg, Lerager (Eriksen), Delaney, Braithwaite, Joergensen, Bruun Larsen (Gytkjaer).

Zeneli pati edhe dy raste në pjesën e dytë që nuk i shfrytëzoi, kurse në minutën e 63-të u akordua penallti për mysafirët, dhe nga pika e bardhë i

pagabueshëm ishte Christian Eriksen, duke shënuar për 1-1. Tre minuta më vonë Zeneli asistoi për Bersant Celinën, i cili nga afërsia e mposhti portierin danez dhe e riktheu epërsinë e "dardanëve" në 2-1. Mysafirët tentuan edhe dy herë për ta barazuar rezultatit dhjetë minuta para fundit, por Ankersen u bllokua nga Vojvoda dhe Dolberg gjuajti me kokë jashtë portës. Kur të gjithë priten që Kosova të shijojë fitoren, në skenë doli Pierre-Emile Hoejbjerg, duke e vulosur rezultatit final 2-2. Portieri i Danimarkës, Kasper Schmeichel, pas barazimit me Kosovën, ka thënë se ishte një ndeshje e vështirë dhe se rezultati 2-2 ishte real. "Ishte një lojë e vështirë për ne, por ishte një kohë e gjatë që nuk patëm luajtur së bashku. Kosova luajti shumë mirë. Barazimi është rezultat real i ndeshjes. Ishim të fokusuar në ndeshjen ndaj Kosovës. Nesër do ta analizojmë këtë lojë dhe t'i shohim gabimet. Do të provojmë që të bëjmë më të mirën kundër Zvicrës", ka thënë portieri i Leicester City.

SHKURT

U17-shtat mbajtën stërvitjen e parë në Zvicër

Përfaqësuesja e Kosovës U17 në futboll mbajti dy herë stërvitje, paradite dhe pasdite, para ndeshjeve të rrethit elitë për Evropianin 2019. Të dyja seancat stërvitore, përzgjedhësi Besnik Kollari me bashkëpunëtorë, provuan disa skema të lojës dhe sisteme të ndryshme me mundësi transformimi gjatë ndeshjes. Futbollistët e rinj punuan me përkushtim në mbrojtje dhe në fazën e sulmit sikur që e bën ndërlidhjen mes reparteve nëpërmjet një mesfushë të lëvizshme. Kushtet janë të mira për punë, ndërkaq atmosfera brenda grupit është jashtëzakonisht e mirë. Të kujtojmë se ndeshjen e parë Kosova do ta ketë të hënën më 25 mars kundër Ukrainës prej orës 11:00.

Panucci: Lenjani tregoi mungesë respekti

Christian Panucci një ditë para ndeshjes ndaj Turqisë foli në lidhje me akuzat e Ermir Lenjanit, i cili bëri me dije se nuk do të rikthehet te Shqipëria derisa trajneri të jetë Panucci. Trajneri italian ka thënë se futbollisti tregoi mungesë respekti. "E kam thirrur 6 herë nga 9 herë. Dy javë përpara nuk ka luajtur. Ai nuk ka treguar mungesë respekti ndaj Panuccit apo Dukës, por ndaj Shqipërisë. Të them të drejtën, nuk ia vlen ta komentoj një letër që poston në 'Instagram', se më bën të qesh. Më mbetet vetëm ta respektoj vendimin e tij përderisa nuk vjen derisa të jem unë", ka thënë Panucci.

Hasani vizitoi Festivalin e Tenisit "Tennis Fest 2019"

Kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, i shoqëruar nga drejtori i Departamentit të Sportit në Ministrinë për Kulturë, Rini e Sport, Ibër Alaj, kanë vizituar Festivalin e Tenisit "Tennis Fest 2019". Organizuar nga Federata e Tenisit e Kosovës (FTK), "Tennis Fest 2019" po mbahet në platenë e Sheshit "Zahir Pajaziti" në Prishtinë, ndërsa po marrin pjesë qindra fëmijë të shkollave fillore në kryeqytet. Presidenti Hasani dhe drejtori Alaj u mirëpritën nga drejtuesit e FTK-së, në krye me kryetarin Mehdi Jashari dhe sekretaren e përgjithshme Fjolla Ibishi, të cilët i kanë përgëzuar për idenë dhe organizimin e këtij festivali. Festivali i Tenisit do të vazhdojë edhe sot (e premte).

Shqipëria me fitore synon t'i nisë eliminatoret për Evropian

TIRANË, 21 MARS - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll sonte (e premte) fillon fazën eliminatore për "Euro 2020". Kundërshtarja e parë e kuqezinjve në Shkodër është Kombëtarja e Turisë, kurse

synimi i shqiptarëve është ta nisnin me fitore kampanjën kualifikuese për Kampionatin Evropian. Trajneri Christian Panucci e ka vlerësuar lart kundërshtarin, por

ka thënë se Shqipëria do të luajë për fitore. "Unë jam pozitiv dhe skuadra është e përgatitur. Ka kualitet, siç ka edhe Turqia. Jam i bindur që mund të arrijmë një fitore, por gjithçka mbetet për t'u

parë nesër. Duhet ta japim maksimumin në fushë", ka deklaruar Panucci. Ndeshja Shqipëri - Turqi fillon në orën 20:45, kurse zhvillohet në stadiumin "Loro Boriçi" në Shkodër.



Shillova: Partizani më kërkoi në janar

Prishtinë, 21 mars - Mes shumë emrave të huaj për një qendërsulmues, Partizani tentoi në janar edhe golashënuesin e Superligës së Kosovës, Alban Shillova, por manërvëshja nuk u gjet. Lajmin e ka konfirmuar vetë sulmuesi 26-vjeçar. Ky i fundit luan aktualisht te Flamurtari i Prishtinës, ndërsa pesë vjet më parë ka qenë edhe pjesë e Bylisit në Kategorinë

Superiore, pikërisht në gjysmën e dytë të sezonit 2013-2014, ku dhe ballshiotët u përjashtuan nga kampionati pas incidenteve në ndeshjen ndaj Laçit. Shillova luajti vetëm gjashtë ndeshje në Superiore dhe më pas u kthye në Kosovë, ndërsa tashmë lë gjithçka të hapur për një transferim në verë të Partizani. "Jam gati ta provoj veten në

një kampionat edhe më të fortë. Mund t'ju zbuloj se në janar kam pasur ofertë nga Partizani i Tiranës, por edhe ekipe të tjera nga kampionati shqiptar. Nuk u arrit diçka me Partizanin, sepse nuk ka qenë diçka shumë konkrete. Megjithatë, shpresoj që në verë të kem një ofertë serioze", deklaroi Shillova për "RTV Dukagjini".



MKRS-ja përkrah sportistë e trajnerë në shumën mbi 70 mijë euro

PRISHTINË, 21 MARS - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në kuadër të mbështetjes financiare për federatat e sportit, ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me Komitetin Paraolimpik të Kosovës, Federatën e Minigolfit të Kosovës, me shtatë sportistë dhe katër trajnerë të dalluar dhe që kanë korrur rezultate. Shuma e përgjithshme e kësaj përkrahje është mbi 70 mijë euro.

Sipas memorandumeve të nënshkruara, Komiteti Paraolimpik mbështetet me shumën prej 25 mijë eurosh, Federata e Minigolfit mbështetet financiarisht në vlerë prej 10 mijë eurosh. Ndërkaq sportisti Musa Hajdari mbështetet financiarisht në vlerë prej 2 250 eurosh, Orges Arifi mbështetet me 2 250 euro, sportistja Fortesa Orana mbështetet me 3 000 euro, Herolind Nishefci me 9 000 euro, sportistja Adelina Rama me 3 000 euro, sportisti Blondin Pakashitica me 2 250 euro dhe Donjeta Sadiku mbështetet me mjete financiare në vlerë prej 1 875 eurosh. Kurse trajneri Nazmi Gashi me 1 500 euro, trajneri Zijadin Kryeziu me 1 125 euro, trajneres Shqipe Zogjani i është



ndarë për mbështetje shuma në vlerë prej 8 250 eurosh dhe trajneri Besim Brahimi u mbështet me 937.50 euro. Me këtë rast ministri Gashi ka thënë se qëllimi i mbështetjes financiare për sportistë është bërë në bazë të kategorizimit dhe se MKRS-ja është e angazhuar që t'i përkrahë sa më shumë sportistët dhe trajnerët e tyre për t'i nxitur ata që të punojnë edhe më shumë që t'i realizojnë objektivat dhe planet e tyre për vitin 2019. "Këto memorandume, përveçse janë një stimulim, janë edhe një argument që shteti po u qëndron afër sportistëve, trajnerëve dhe federatave sportive, në mënyrë që ato të funksionojnë me efikasitet sa

më të plotë, të kenë mbështetje dhe pavarësi financiare dhe të realizojnë aktivitetet e planifikuara ashtu që sporti i Kosovës të avancohet edhe më shumë, ngaqë Kosova ka shumë talentë në sport", ka thënë ministri Gashi.

Ndërsa përfituesit nga kjo mbështetje e falënderuan ministrin Gashi dhe stafin e MKRS-së për punën e mrekullueshme që janë duke e realizuar. Ata u zotuan se Kosovën do ta përfaqësojnë në mënyrë dinjitoze kudo që marrin pjesën nëpër gara, brenda dhe jashtë vendit. Ata thanë se do të fokusohen në ngritjen e cilësisë në sportet e tyre përkatëse me të cilat merren.

Humbje surprizë nga Houstoni, Bucks dhe Spursi

MEMPHIS, 21 MARS - Surprizë në ndeshjet e NBA-s, siç është fitorja 107-102 që Clevelandi arriti ndaj Milwaukee, dy ekipe që renditen në skajet e kundërta të renditjes në Lindje. Ndeshje e dominuar shumicën e kohës nga Cavaliersi, ku u dalluan Sextoni me 25 pikë e Clarksoni me 23. Pas kohës shtesë fiton Chicago, që mundi 126-120 Washingtonin, takim me rivalitet dhe emocione deri në fund. Markkanen me 32 pikë e 13 rebounde ishte shënuesi më i mirë i ndeshjes. Humbet San Antonio, që ndalet pas 9 fitoresh radhazi. Spursi u mundi 110-105 nga Miami, një tjetër rezultat surprizë.

Koha shtesë ndal Oklahomën, që u mundi 123-114 nga Toronto. I zakonshmi Russell Westbrook realizoi 42 pikë e 11 rebounde, por i vetëm nuk mundi ta ndalte furinë kanadeze: Siakam 33 pikë, VanVleet 23 pikë e Leonard 22 pikë. Pas kohës shtesë ndalet edhe Houstoni, që u mundi 126-



125 nga Memphis, ndeshje e vendosur në sekondën e fundit. Conley me 35 pikë e Valanciunas me 33 pikë e 15 rebounde u dalluan për Memphisin, duke i bërë të pavlefshme 57 pikë e Hardenit për teksanët. Orlando, falë 22 pikëve të Fournierit dhe 20 të Gordonit, mposhti 119-96 New Orleansin, ndërsa Philadelphia fitoi duelin ndaj Bostonit 118-115. Ndeshje e mirë e Embiidit, që realizoi 37 pikë e 22 rebounde.

REZULTATET

Cleveland - Milwaukee	107-102
Orlando - New Orleans	119-96
Philadelphia - Boston	118-115
New York - Utah Jazz	116-137
Chicago - Washington	126-120
Memphis - Houston	126-125
San Antonio - Miami	105-110
Oklahoma - Toronto	114-123
Portland - Dallas	126-118

SHKURT

Ronaldo dënohet 20 mijë euro

Cristiano Ronaldo do të jetë në të dyja sfidat me Ajaksin në Ligën e Kampionëve dhe do të marrë vetëm një gjobë nga UEFA ashtu si Simeone. Komiteti Disiplinor i UEFA-s u takua dhe vendosi për dënimin e portugezit, i cili ua tregoi "b...." tifozëve të Atletico. Kështu ai do të gjobet si Simeone, me një gjobë prej 20 mijë eurosh dhe do të jetë rregullisht në ndeshjet kundër Ajaksit. Pra, çdo frikë për shkualifikim tani më nuk ekziston për Juventusin. Kujtojmë se pas shënimit të golit të dytë, portugezi u "hakmor" ndaj Simeones, duke bërë të njëjtin gjest që bëri trajneri në Spanjë. Megjithatë, kishte dyshime se Ronaldo ishte drejtuar nga tifozët spanjollë dhe jo nga të tjtë, ashtu siç bëri Simeone.

Icardi rikthehet në stërvitje me Interin

Duke pritur për të kuptuar se çfarë do të ndodhë në të ardhmen e tij, Mauro Icardi është kthyer në trajnim me Interin në "Appiano Gentile". Fillimi i pranverës solli një frymë paqeje në shtëpinë zikaltër, me sulmuesin argjentinas, i cili në mëngjes u prit me entuziazëm nga disa tifozë në kthimin e tij në kampin stërvitor. Siç raportohet nga "Sky Sport", ish-kapiteni i Interit u stërvit fillimisht në palestër me shokët para se të shkonte në fushë dhe ta vijonte punën me një trajner, duke kryer disa ushtrime të personalizuara për ta përmirësuar gjendjen fizike. Seanca përfundoi me fizioterapi për problemin e gjurit.

Lyoni, gati ta transferojë Giroudin

Lyon është gati ta mirëpresë sulmuesin e Chelseat, Olivier Giroud, në rast se francezi largohet nga "Stamford Bridge" në fundin e këtij sezoni. E ardhmja e 32-vjeçarit është ende e paqartë, pasi kontrata e tij me "blutë" përfundon në fund të këtij sezoni dhe ende nuk i është ofruar rinovimi. Për këtë arsye, francezët janë gati t'i ofrojnë sulmuesit 3.5 milionë euro në sezon, shumë që ai e përfiton aktualisht te Chelsea, plus një vend në formacionin titulluar. Aktualisht Lyoni renditet i treti në Ligën 1, pozicion që sezonin e ardhshëm i garanton një vend në Ligën e Kampionëve në sezonin e ardhshëm, një kompeticion që vështirë se Giroud do të refuzonte të luante.

Sauli preferon Cityn para Barçës

Saul Niguez është në listën e shumë skuadrave të mëdha dhe duket se në verë mund ta lërë Atletico Madridin për të nisur një tjetër aventurë. Barcelona prej kohësh ka shfaqur interesimin për drejtimin e mesfushorit, por duket se ai është joshur nga projekti i Cityt dhe nga dëshira për të punuar me Pep Guardiolen. Mediet në Angli janë të sigurta se ai ka pranuar ofertën e "qytetarëve". Atletico fillimisht kërkoi 120 milionë euro, por duket se me kalimin e ditëve i uli pretendimet.

Sanches: Nuk jam i lumtur në Bayern, puna ime nuk po shpërblehet

Verën e vitit 2017 Bayern Munchen shpenzoi plot 35 milionë euro për t'i siguruar shërbimet e Renato Sanchesit, i cili erdhi nga Benfica. Kur kanë kaluar gati dy vjet, portugezi ende nuk ka arritur të bëhet pjesë e rëndësishme e Bayernit dhe hapësirat për të kanë qenë të pakta. Së fundmi, 21-vjeçari duket se nuk ka duruar dhe ka shpërthyer, duke deklaruar se nuk ndihet i lumtur dhe se ka nevojë të luajë. Gjithashtu, Sanches ka shtuar edhe se po mendon seriozisht të largohet, pasi kërkon patjetër të marrë minuta, pasi në Gjermani nuk po i jepet mundësia. "Nuk jam i lumtur këtu. Po punoj shumë fort, por kurrë nuk më jepet mundësia për të luajtur. Puna ime nuk po shpërblehet. Kam nevojë të luaj më shumë, ndoshta në një klub tjetër. Më duhet ta mendoj seriozisht këtë gjë", ka deklaruar Sanches.



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Prishtinë, 22.03.2019 – Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës - (1 vende pune)

Emri i Institucionit: Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës

Titulli i vendit të punës: Zyrtar Ligjor

Numri i Referencës: AACK/ADM/BNJ/02/2019

Tarifa e shërbimit: 875.00 (Bruto)

Raporton te: Drejtori i përgjithshëm

Lloji i kontratës: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - (MSHV)

Kohëzgjatja e kontratës: Me afat 6 muaj, me orar të plotë

Orari i punës: I plotë, 40 orë në javë

Lokacioni: Prishtinë, Arbëri "Rruga Ahmet Krasniqi" Nr.208, 10000

Qëllimi i vendit të punës Ofrimi i shërbimeve dhe këshillave profesionale në fushën e hartimit të politikave dhe legjislacionit në Autoritetin e Aviacionit Civil.

Detyrat kryesore:

- Hartim akte normative si dhe aktet tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtaria e institucionit në bazë të procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Siguron përputhshmërinë e projektligjeve dhe akteve tjera nënligjore me legjislacionin në fuqi në Kosovë;
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identike në të tri gjuhët zyrtare;
- Bën hulumtime dhe analiza të informatave në temat e caktuara nga mbikëqyrësi dhe identifikon opsionet ose çështjet për shqyrtim.
- Sipas kërkesës dhe sipas udhëzimeve të nivelit më të lartë jep opinione ligjore si dhe bën hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera;
- Bashkëpunon dhe komunikon me njësitë tjera brenda dhe jashtë institucionit për aktivitetet që ndërlihen me fushën e legjislacionit;
- Ofron këshilla ligjore, rekomandime, udhëzime dhe opinione për drejtorin e përgjithshëm brenda kompetencave të AAC-së sipas ligjit;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare Fakulteti juridik, minimum 2 vite përvojë pune në fushën përkatëse
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e legjislacionit dhe hartimin e akteve ligjore;
- Përvojë në përfaqësim të palëve
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohuri të mira të gjuhës angleze dhe serbe.

Autoriteti i Aviacionit Civil mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore, nga të gjitha komunitetet.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim e të drejtave civile dhe politike, të kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit

Konkursi është i hapur shtatë (7) ditë nga data 22.03.2019 deri më 28.03.2019 shpalljes në gazeta të përditshme kosovare dhe në faqen zyrtare të AACK-së në internet. Data e fundit për aplikim është 28.03.2019 deri në ora 16:00, të gjitha aplikacionet e kompletuara, të dërguara deri më këtë datë, do të konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave:

Formularët e aplikimit mund të merren nga faqja zyrtare e AACK-së në internet, në <http://caa-ks.org/category/lajme/> ose në selinë e AACK-së, Rr. Ahmet Krasniqi Nr.208, Lagjia Arbëria, 10000 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në orën 16:00, deri në ditën e fundit për konkurim.

Aplikacionet dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet personale mund të dorëzohen nëpërmes postës elektronike në e-adresën: Safete.Selmani@caa-ks.org ose në adresën postare të cekur më lart, me shënimin "Për rekrutim - pozita në të cilën konkuroni". Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Për informata plotësuese mund të kontaktoni në numrin 038 248 629 lok. 106.

Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, ashtu siç specifikohet në nenin 11 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/1-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Univerziteteske Bolničke i Kliničke Službe Kosova (UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinički Centar Kosova –

University Clinical Center of Kosovo

Sektori i Personelit

Nr.Ref. 278/19, datë 20.03.2019.

Në bazë të nenit 13 pika 3 e Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës, nenit 6 pika 5.1, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe Kërkesës nr. 278/3 të datës 19.03.2019, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, nxori këtë:

V E N D I M

Për përsëritje të pjesërishtme të Konkursit publik,

- Konkursi publik nr. 278, datë 26.02.2019, për **Inxhinier të Arkitekturës dhe Inxhinier të Ndërtimtarisë (6 pozita), Inxhinier të Elektros (1 pozitë) dhe Inxhinier të Makinerisë (1 pozitë)** për shkak të numrit jo të mjaftueshëm të kandidatëve, vazhdohet pjesërisht edhe për 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga mjetet e informimit këto dy pozita:
 - Inxhinier të Elektros (1 pozitë); dhe
 - Inxhinier të Makinerisë (1 pozitë).
- Obligohet Sektori i Personelit për zbatimin e këtij Vendimi;
- Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Përzgjedhës me Vendimin nr. 278/2, dt. 28.02.2019 pas shqyrtimit të dokumentacionit të kandidatëve që aplikuan në konkursin publik për Inxhinier të Arkitekturës dhe Inxhinier të Ndërtimtarisë (6 pozita), Inxhinier të Elektros (1 pozitë) dhe Inxhinier të Makinerisë (1 pozitë), nr. rendor 2 e 3 nuk e plotësojnë bazën e konkursit për shkak të numrit të vogël të konkurrentëve dhe kërkojnë që konkursi të vazhdohet sipas nenit 6, pika 5.1 e Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, edhe 15 ditë. Ndërsa për numrin rendor 1 Inxhinier të Arkitekturës dhe Inxhinier të Ndërtimtarisë të fillohet me procedura e përzgjedhjes.

Prandaj, Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së, në bazë të kompetencave, konform ligjit në fuqi dhe Kërkesës në fjalë, lejon përsëritjen e pjesërishtme të Konkursit publik si në didpozitiv të këtij Vendimi.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

VENDIMI T'Ë DORËZOHET

- ✓ Zyrës së personelit,
- ✓ Një mediumit informativ.
- ✓ Arkivit.

Drejtori i Përgjithshëm i SHSKUK-së

Dr. Basri Sejdiu



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Univerziteteske Bolničke i Kliničke Službe Kosova (UBKSK)

Hospital and University Clinical Service of Kosovo (HUCSK)

Qendra Klinike Universitare e Kosovës – Universitetski Klinički Centar Kosova –

University Clinical Center of Kosovo

Sektori i Personelit

Ref. Br. 278/19, data 20.03.2019.

Na osnovu člana 13, stav 3 Statuta Službe Bolnice i Kliničke Universiteteske Kosova, član 6 tačka 5.1, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o Regulisanju Procedura Javnog Konkursa i Zahtevu br. 278/3 od 19.03.2019, Generalni Direktor UBKSK je izdao:

O D L U K A

Za delimično ponavljanje javnog konkursa,

- Javni konkurs br. 278, od 26.02.2019, za Inženjer arhitekture i inženjera građevinarstva (6 pozicija), inženjera elektrotehnike (1 položaj) i inženjera mašinstva (1 pozicija) zbog nedovoljnog broja kandidata, nastavlja se delom za 15 dana od dana objavljivanja u jednom od sredstava informisanja ove dve pozicije: 1. Elektros inženjer (1 pozicija); i Inženjer mašina (1 pozicija).
- Sektor za osoblje je obavezan da sprovede ovu Odluku;
- Odluka stupa na snagu danom potpisivanja.

O b r a z l o ž e n j e

Komisija za izbor sa Odlukom br. 278/2, dt. 28.02.2019. Nakon razmatranja dokumentacije kandidata koji se prijavljuju za javni konkurs za inženjera arhitekture i inženjera građevinarstva (6 pozicija), Inženjera elektrotehnike (1 položaj) i Inženjera mašinstva (1 pozicija), redovni broj 2 i 3 ne popunjavaju bazu konkursa zbog malog broja kandidata i zahtevaju da se konkurencija nastavi prema članu 6, odeljak 5.1 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju postupka javnog konkursa, još 15 dana. Za redovnim broj 1 Inženjer arhitekture i inženjer građevinarstva počinje sa postupak izbora.

Prema tome, Generalni Direktor UBKSK, u skladu sa nadležnostima, i sa važećim zakonom i predmetnom Zahteva, dozvoljava ponavljanje javnog konkursa kao u dispozitivu na ovu odluku.

Kao što je već navedeno, odlučeno je kao u dispozitivu ove odluke.

ODLUKA KOJI SE PODNOSI

- * Kancelarija za kadrove,
- * Informacioni medij.
- * Arhiva.

Generalni Direktor UBKSK.

Dr. Basri Sejdiu



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – KANCELARIJA PREDSEDNIKA

ZYRA E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

SHBALL KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS:

Titulli i vendit të punës:	Drejtor i Departamentit të Informacionit dhe Komunikimit me Publikun
Nr. referues i vendit të punës:	RP00085359
Kategoria funksionale:	Niveli Drejtues
Lloji i vendit të punës:	Pa afat të caktuar dhe orar të plotë pune
Departamenti:	Departamenti të Informacionit dhe Komunikimit me Publikun
Raporton te:	Presidenti i Republikës / Sekretari i Zyrës së Presidentit

Qëllimi i vendit të punës

Te asistojë Presidentit dhe Sekretarit në zhvillimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave në tërësi e në veçanti në çështjet informimit dhe të komunikimit publik për të siguruar që ZPRK arrin objektivat e saja.

Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore:

- Udhëheq dhe kontrollon stafin e Departamentit për të siguruar që janë të motivuar dhe të trajnuar si duhet dhe i kryejnë detyrat e tyre sipas standardeve të kërkuara;
- Ofron përkrahje profesionale për Presidentin, duke ofruar këshilla për efektivitet të prezantimit të opinionëve dhe qëndrimeve të ZPRK-së;
- Bën përgatitjen, mirëmbajtjen dhe zbatimin e planit të komunikimit në bazë të planit të punës së ZPRK-së, duke zbatuar teknika efektive të komunikimit;
- Bashkëpunon me Zëdhënësin e Presidentit (këshilltarin për shtyp) për organizimet e konferencave për shtyp dhe intervistave;
- Përpilon dhe lëshon kumtesa për shtyp, deklaratat, raporte dhe publikime të tjera për publikun;
- Është përgjegjës për përditësimin, sigurimin e qasjes dhe kredibilitetin e informatave në ueb-faqen zyrtare të ZPRK-së dhe menaxhon me e-mail adresën për komunikim me publikun
